



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A.nr. 121/2023

në lidhje me zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë lidhur me lëndën C. nr. 1793/2021

Drejtuar: Z. Bekim Veliqi, U.D. Kryetar
Gjykata Themelore në Mitrovicë

Prishtinë, më 16 prill 2025

Qëllimi i raportit

Raporti ka për qëllim të adresoi çështjen e vendosjes brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata dhe bazohet në shqetësimet e ngritura nga ankuesi Musa Haxhiu i cili ankohet për zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën C. nr. 1793/2021, si dhe ka për synim të tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Mitrovicë (GjThM) lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për ta shqyrtuar dhe për të vendosur në këtë rast pa vonesa të mëtejshme.

E drejta për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm është e garantuar me Kushtetutë si dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çdo kush e ka të drejtën që çështja e tij të shqyrtohet me drejtësi, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata. Siç është theksuar disa herë nga GJEDNJ sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që qojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në ato, përkundrazi organizimi i sistemit juridik duhet t'u ofroj gjykatave të gjitha kushtet me qëllim të shqyrtimit të rasteve brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Baza ligjore

1. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8, përcakton: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”*

Përmbledhje e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon IAP-ja, mund të përmbledhen si në vijim:

3. Në bazë të informacioneve të ofruara nga ankuesi vërehet se në GjThM po zhvillohej procedura gjyqësore lidhur me lëndën C. nr. 1793/2021.
4. Sipas pohimeve të ankuesit, vërehet se më 15 dhjetor 2021, ai parashtroi padi në GjThM dhe kërkoi kompensim dëmi, por gjykata nuk vendosi deri në kohën kur ankuesi parashtroi ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit.
5. Më 8 shkurt 2023, Institucioni i Avokatit të Popullit pranoi ankesë nga z. Musa Haxhiu, parashtruar kundër GjThM-së, për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore lidhur me lëndën C.nr.1793/2021.
6. Më 13 mars 2023, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i kontaktoi përfaqësuesit e GjThM-së dhe u kërkoi informata lidhur me çështjen e ankuesit.
7. Më 23 mars 2023, përfaqësuesit e GjThM-së kthyen përgjigje dhe e njoftuan përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se lënda e ankuesit ka status të pazgjidhur dhe aktualisht nuk mund të procedohet tutje për shkak se gjyqtarja e ngarkuar me rastin e ankuesi është e komunitetit serb dhe e cila dha dorëheqje nga pozita e gjyqtares, sikurse edhe gjyqtarët e tjerë të komunitetit serb.
8. Më 2 prill 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i kontaktoi përfaqësuesit e GjThM-së dhe u kërkoi informata lidhur me çështjen e ankuesit dhe u njoftua se rasti i ankuesit do të trajtohet sipas radhës së arritjes në gjykatë.

9. Më 6 nëntor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i kontaktoi përfaqësuesit e GjThM-së dhe u kërkoi informata lidhur me çështjen e ankuesit.
10. Më 11 nëntor 2024, përfaqësuesit e GjThM-së kthyen përgjigje dhe e njoftuan përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se rasti i ankuesit do të trajtohet sipas radhës së arritjes në gjykatë.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: *“Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]”*
12. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
13. Po ashtu mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parasheh: *“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*
14. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.¹ Ndërsa paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së garanton: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.”*
15. Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton: *“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”*
16. Ndërsa neni 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat përcakton: *“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”*

Analiza ligjore

17. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ).
18. GjEDNJ-ja, në disa raste, ka theksuar se e drejta e palës që për çështjen e saj të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

19. Avokati i Popullit gjen se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih mes të tjerash Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005, dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).
20. Avokati i Popullit, lidhur me mosinformimin e palës për fazën në të cilën gjendet lënda e vet, gjen se sipas vendimeve të GjEDNj-së, një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohe të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).
21. Sipas praktikës së gjykatës (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga data 15 dhjetor 2021, kur ankuesi parashtoi padi në GjThM, e deri në ditën e publikimit të këtij raporti.
22. Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive për trajtimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, e drejtë kjo e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës [E drejta për zgjidhje efektive], i cili përcakton: “Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”
23. Më tej neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht t’i mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ, që bën të mundur që ai/ajo t’i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtojë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih Aktgjykimin *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv te një autoritet vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
24. Për sa i përket zbatimit të nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).
25. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe ta lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë

efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

26. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar apo mosvazhdimin e saj, ose të ofronin përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).
27. Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes të cilit ankuesi do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

28. Avokati i Popullit rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret është data 15 dhjetor 2021, dhe konstaton se zvarritja e tillë, pa vendim përfundimtar, shkel:

- *të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuara dhe të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;*
- *të drejtën për mjete efektive juridike, e mbrojtur me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;*
- *të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*

29. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, në bazë të nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 16, paragrafi 8, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i

REKOMANDON

Gjykatës Themelore në Mitrovicë:

- *Pa vonesa të mëtejme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për ta shqyrtuar dhe për të vendosur për lëndën C.nr.1793/2021.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,
Naïm Qelaj
Avokat i Popullit

